



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 599 Akti

Nr.329 Vendimi  
Tiranë, më 6.1.2021

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

**Brunilda Bekteshi** Kryesuese  
**Lulzim Hamitaj** Relator  
**Olsi Komici** Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 5.1.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë mori në shqyrtim, në seancë dëgjimore publike, çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** Znj. Arta Duka, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Duka, me detyrë<sup>1</sup> gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila në seancën dëgjimore publike, të datës 5.1.2021, kërkoi konfirmimin e saj në detyrë,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

- i. Znj. Arta Duka ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, në: Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtorinë e Sigurimit të Informacioneve të Klasifikuara (në vijim DSIK); si dhe pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim KLD).
- ii. Pika 4, e nenit 179/b, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se: *“Të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë [...] do të rivlerësohen, ex officio”*. Në këto kushte, dhe duke konsideruar kandidimin e subjektit për emërim në Gjykatën e Apelit, ka filluar me përparësi procedura e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Arta Duka.
- iii. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, për shkak të përparësisë së këtij rivlerësimi, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur një short të veçantë, në datën 16.7.2020, nga i cili rezultoi se për subjektin e rivlerësimit, znj. Arta Duka, procesi i rivlerësimit do të kryhej nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici.
- iv. Trupi gjykues i sipërpërmendur, pasi administroi dhe studioi të tri raportet e përcjella nga organet ndihmëse, sipas parashikimeve të neneve 31 – 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, në datën 27.7.2020, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohej kryesuese e trupit gjykues komisionere Brunilda Bekteshi. Gjithashtu, në këtë mbledhje, anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit në fjalë.
- v. Pasi ishte përfunduar faza hetimore mbi rivlerësimin e subjektit Arta Duka, me vendimin nr. 2, të datës 16.12.2020, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimet dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tri kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.

---

<sup>1</sup> Në datën 16.9.2020, znj. Arta Duka, është komanduar në skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit Korçë.

- vi. Në datën 16.12.2020 Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: rezultatet e hetimit kryesisht – duke e ftuar për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën – për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, duke i dhënë kohë për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegimet.
- vii. Ndonëse nuk u njoh me dosjen përkatëse, subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet e saj mbi rezultatet e hetimit kryesisht, përpara afatit të caktuar nga Komisioni.
- viii. Në datën 21.12.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 3, vendosi të ftojë, përmes postës elektronike, subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në datën 5.1.2021, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

- i. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Arta Duka, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit.
- ii. Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, znj. Arta Duka, ka parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke iu referuar dhe qëndruar atyre të paraqitura më herët me shkrim.
- iii. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
- iv. Seanca dëgjimore e datës 5.1.2021 u mbyll, për të rifilluar më 6.1.2021, për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

## **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ); (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet e paraqitura në seancën dëgjimore; (ix) faktet e njohura botërisht.

## A. VLERËSIMI I PASURISË

### A/1 VLERËSIMI I PASURISË NGA ILDKPKI-JA

Bazuar në nenet 30 – 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaratim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

### A/2 RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

#### **1. Tokë bujqësore “arë” dhe “arë dhe truall” me sipërfaqe totale 23.433 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Korçë, përfituar në bazë të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”**

1. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në Deklaratën e Interesave Private Para Fillimit të Detyrës në vitin 2010, si një tokë bujqësore me sipërfaqe 24 dynym dhe më pas në deklaratën *Vetting*: tokë bujqësore “arë” dhe “arë dhe truall” me sipërfaqe totale 23.433 m<sup>2</sup>.
2. Pasuria e lartpërmendur rezulton të jetë përfituar me anë të AMTP-së nr. \*\*\*, të lëshuar në datën 17.11.1995, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, shtetasit G. V. B.<sup>2</sup> i është dhënë në pronësi tokë me sipërfaqe prej 23.433 m<sup>2</sup>, nga të cilat 22.933 m<sup>2</sup> tokë “arë” dhe 500 m<sup>2</sup> “truall”. Mbi sipërfaqen e këtij trualli ka rezultuar ekzistenca e një banese me sipërfaqe prej 173 m<sup>2</sup>.
3. Në vitin 2005 rezulton të jetë shitur një pjesë e kësaj pasurie, prej 5.320 m<sup>2</sup>, pas së cilës sipërfaqja e mbetur në bashkëpronësi është 18.013 m<sup>2</sup>. Lidhur me pasaktësinë në deklaratimin e sipërfaqes së mbetur në bashkëpronësi, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka shpjeguar se ka qenë një lapsus i paqëllimshëm, për sa kohë pasuria në fjalë është përfituar pa kundërshtim në vitin 1991 dhe nuk ka pasur dijeni të saktë në lidhje me sipërfaqen e tokës së disponuar. Po ashtu, subjekti ka specifikuar se të ardhurat nga kjo shitje nuk janë përdorur prej saj si burim, për krijimin e ndonjë pasurie.

---

<sup>2</sup> Babai i subjektit të rivlerësimit.

4. Lidhur me pjesën takuese prej 16.6 %, të deklaruar në deklaratën *Vetting*, është ftuar subjekti me anë të pyetësorit nr. 2, që të vinte në dispozicion edhe certifikatën familjare të datës 1.8.1991, në bazë të së cilës është përlllogaritur edhe përfitimi i pasurisë në fjalë. Nga certifikata familjare e paraqitur ka rezultuar se asokohe në përbërjen familjare kanë qenë gjashtë anëtar/përfitues<sup>3</sup> – nga ku konfirmohet se pjesa takuese e përfituar nga subjekti rezulton në masën prej 1/6 ose 16.6 %.
5. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pasuria aktualisht përdoret nga familja e saj e origjinës dhe se ajo personalisht nuk ka kryer ndonjë shpenzim për ndërtim, riparim apo mobilim.
6. Përgjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin e listuar, si vijon:
  - i. Me vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 5.9.2016, ZVRPP-ja Korçë ka konfirmuar se AMTP-ja nr. \*\*\* është arkivuar dhe regjistruar në emër të shtetasit G. V. B., në cilësinë e kryetarit të familjes bujqësore, një sipërfaqe totale 23.433 m<sup>2</sup>, tokë e ndodhur në fshatin \*\*\*, Korçë, nga të cilat tokë “arë” me sipërfaqe 20.480 m<sup>2</sup> dhe “truall dhe arë” me sipërfaqe 2.945 m<sup>2</sup>.
  - ii. AMTP-ja nr. \*\*\* është lëshuar në datën 17.11.1995, në mbështetje të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, sipas të cilit familjes së shtetasit G. V. B. i jepet në pronësi tokë, gjithsej 23.433 m<sup>2</sup>, nga të cilat 22.933 m<sup>2</sup> tokë arë dhe 500 m<sup>2</sup> truall.
  - iii. Certifikatë familjare e datës 1.8.1991 e familjes bujqësore.
  - iv. ASHK-ja Korçë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.10.2020, ka informuar se në emër të shtetasit G. V. B. rezultojnë të regjistruara pasuritë:
    - a) pasuria e llojit “arë” me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, \*\*\*, Korçë, me sipërfaqe 4.430 m<sup>2</sup>;
    - b) pasuria e llojit “arë dhe truall” me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, \*\*\*, Korçë, me sipërfaqe 2.845 m<sup>2</sup>, nga këto 500 m<sup>2</sup> truall sipas Aktit nr. \*\*\*, ndërsa sipas referencës \*\*\* n. 1997, sipërfaqja totale është 2.845 m<sup>2</sup>, nga të cilat 200 m<sup>2</sup> truall dhe 173 m<sup>2</sup> ndërtesë;
    - c) pasuria e llojit “arë” me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, \*\*\*, Korçë, me sipërfaqe 6.156 m<sup>2</sup>;
    - d) pasuria e llojit “arë” me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, \*\*\*, Korçë, me sipërfaqe 4.582 m<sup>2</sup>;
    - e) pasuria e llojit “arë” me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, \*\*\*, Korçë, me sipërfaqe 5.320 m<sup>2</sup>, e cila është tjetërsuar në pronësi të shtetasit S. N.
  - v. ASHK-ja Korçë i ka bashkëngjitur shkresës kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.5.2005, sipas së cilës pala shitëse G. B., L. B., P. B. dhe A. B.<sup>4</sup> i kanë shitur blerësit Stefanaq Ndoni pasurinë e llojit “arë” me sipërfaqe 5.320 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit prej 100.000 lekësh.

<sup>3</sup> Në certifikatë rezultojnë shtatë persona, por njëri prej tyre, shtetasi S. B., stërgjyshi i subjektit të rivlerësimit i lindur në datën 4.4.1875, sipas informacionit të sjellë nga subjekti, ka ndërruar jetë në vitin 1974 në SHBA dhe nuk është bërë i mundur çregjistrimi i tij nga gjendja civile.

<sup>4</sup> Mbiemri i vajzërisë së subjektit të rivlerësimit.

7. Lidhur me pasurinë e analizuar sa më sipër, përgjatë hetimit administrativ, nuk është konstatuar ndonjë problematikë lidhur me burimin financiar apo ndonjë kontribut financiar nga subjekti i rivlerësimit për përfitimim e kësaj pasurie.

## **2. Apartament banimi në përdorim, në lagjen “\*\*\*\*”, Rr. “\*\*\*\*”, Fier**

8. Adresa e këtij apartamenti, si vendbanim, është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2015. Në deklaratën *Vetting*, gjithashtu është deklaruar se ky apartament është zotëruar nga subjekti duke filluar nga qershori i vitit 2015, me kontratë qiraje joshkresore.
9. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se duke filluar nga qershori 2015 dhe deri në gusht 2018<sup>5</sup>, ka banuar së bashku me bashkëshortin në këtë banesë me qira dhe kanë paguar vlerën e qirasë prej 18.000 lekë/muaj në bazë të një marrëveshjeje verbale midis tyre. Gjithashtu, subjekti i ka bashkëngjitur pyetësorit nr. 1 deklaratën noteriale të lëshuar nga shtetasja Aida Ferati<sup>6</sup> (në cilësinë e bashkëshortes së shtetasit A. F. dhe të bashkëpronares së pasurisë në fjalë), në të cilën shprehet se subjektit të rivlerësimit i kanë dhënë me qira apartamentin, nga qershori i vitit 2015 dhe në vijim. Po ashtu, deklaruesja, *de qua*, ka specifikuar se marrëdhënia e qirasë ka qenë verbale dhe me një kuotë qiraje mujore prej 18.000 lekësh, e cila është paguar nëpërmjet bankës, në llogarinë e saj.
10. Lidhur me vendbanimet, gjithmonë në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka informuar se më herët, nga marsi 2012<sup>7</sup> – maj 2015, ajo me bashkëshortin kanë jetuar në një tjetër apartament me qira, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, k. \*\*\*, Fier. Lidhur me përdorimin e këtij apartamenti, subjekti ka vënë në dispozicion kontratë qiraje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.1.2013, të lidhur me shtetasin K. Gj., me një afat 2-vjeçar, kundrejt qirasë në vlerën 16.000 lekë/muaj. Subjekti ka bashkëngjitur gjithashtu certifikatën e pronësisë së këtij apartamenti me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, të regjistruar në emër të shtetasit K. V. Gj.
11. Bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 1, subjekti ka përcjellë në Komision edhe deklaratën noteriale të lëshuar nga bashkëshortja e shtetasit K. Gj., znj. E. Gj., e cila ka deklaruar se kontrata ka qenë fillimisht verbale nga marsi i vitit 2012 dhe më pas, në janar të vitit 2013 palët kanë nënshkruar kontratën e qirasë dhe pagesat përkatëse janë kryer *cash*.
12. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se me të gjithë shtetasit pronarë/qiradhënës të lartpërmendur nuk ka pasur ndonjë lidhje

<sup>5</sup> Nga muaji shtator 2018 dhe në vijim, subjekti ka deklaruar se ka banuar me qira në: lagjja “\*\*\*\*”, Rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, k. \*\*\*, Fier, kundrejt qirasë mujore në vlerën 18.000 lekë. Subjekti ka vënë në dispozicion kontratën e qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.9.2018, të lidhur me shtetasin E. G., si dhe mandatarëkëtimet e kryera nga bashkëshorti në favor të qiradhënësit në “Raiffeisen Bank”, nga shtatori i vitit 2018 deri në korrik të vitit 2020, në vlerën 18.000 lekë (përveç muajit të parë, i cili ka qenë në vlerën 12.000 lekë për sa kohë qiraja ka filluar efektet nga data 10.9.2018).

<sup>6</sup> Bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti ka vendosur një certifikatë familjare të bashkëshortëve A.dhe A. F., si dhe certifikatën e pronësisë së apartamentit të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, të regjistruar në emër të shtetasit A. D. F.

<sup>7</sup> Subjekti ka informuar në përgjigje të pyetësorit nr. 1, se nga momenti i fillimit të detyrës e deri në muajin shkurt 2012, ajo së bashku me bashkëshortin dhe familjen e origjinës së këtij të fundit, kanë jetuar në apartamentin në pronësi të kunatit të saj, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, kompleksi “\*\*\*\*”, Tiranë. Subjekti ka bashkëngjitur gjithashtu kontratën e sipërmarrjes së këtij apartamenti, të datës 9.5.2000 dhe akt mbarimin e kontratës, ku palët kanë konfirmuar shlyerjen e plotë të çmimit. Ky apartament është regjistruar në ASHK në vitin 2015, me anë të lejes së legalizimit, sipas VKM-së nr. 439, datë 2.7.2014, “Për përcaktimin e procedurave të legalizimit të ndërtimeve pa leje, shtesave anesore apo në lartësi të ndërtuara nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.”. Për këtë shoqëri, rezulton të jetë çelur procedura e falimentit me vendimin nr. \*\*\*, nr. \*\*\* Akti, datë 20.7.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

familjare/shoqërore apo të çfarëdolloji<sup>8</sup> dhe ka vendosur në dispozicion të Komisionit vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2020, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me të cilën konfirmohet se subjekti nuk ka shqyrtuar ndonjë çështje gjyqësore me palë shtetasit: K. Gj., E. Gj., A. F., A. F. dhe E. G.

13. Përgjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin e poshtëpërshkruar:
- i. certifikatë pronësie lëshuar në datën 8.8.2007, për pasurinë e llojit apartament me sipërfaqe 102.5 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, e regjistruar në emër të shtetasit A. D. F.;
  - ii. deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 25.10.2016, e shtetases A. F. në cilësinë e bashkëpronares së pasurisë së paluajtshme apartament me nr. pasurie \*\*\*, ku ka deklaruar se këtë pasuri ia ka dhënë me qira subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, kundrejt shumës 18.000 lekë/muaj;
  - iii. mandatarëkëtimet mujore në vlerën 18.000 lekë, të kryera nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në favor të shtetases A. F. në “Credins Bank”, me përshkrimin “arkëtim nga E. D.” ose “kaluar pagesë qiraje E. D.”, të cilat fillojnë nga data 30.6.2015 dhe deri më 27.6.2018<sup>9</sup>;
  - iv. ZVRPP-ja Fier<sup>10</sup> ka konfirmuar me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 15.8.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 18.9.2017, se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur nuk figurojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara.
14. Nga analiza krahasimore e përmbajtjes së dokumenteve të administruara, si dhe deklarimeve dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se gjendja faktike përputhet me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimet e pagesave të kryera për qiramarrjet e lartpërmendura.

### **3. Automjet tip “Audi A4”, viti i prodhimit 2002, blerë në datën 7.6.2016, në vlerën 330.000 lekë**

15. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*<sup>11</sup> dhe më pas në DIPP-në e vitit 2016<sup>12</sup>, përfituar me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.6.2016, me vlerë prej 330.000 lekësh.
16. Gjithashtu, në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie me të ardhurat e krijuara nga kursimet nga pagat, ndërsa në DIPP-në e vitit 2016 burimi i krijimit në fjalë është deklaruar nga kursimet *cash* – jashtë sistemit bankar, të krijuara nga paga e subjektit dhe bashkëshortit.

<sup>8</sup> Bashkëngjitur pyetësorit nr. 2, subjekti ka vendosur në dispozicion të Komisionit vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2020, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në të cilin konfirmohet se subjekti nuk ka shqyrtuar çështje gjyqësore me shtetasit K. Gj., E. Gj., A. F., A. F. dhe E. G.

<sup>9</sup> Mandatarëkëtimet e vendosura në dispozicion nga subjekti në dokumentacionin bashkëngjitur pyetësorit nr. 1.

<sup>10</sup> ZVRPP-ja Tiranë ka konfirmuar, gjithashtu, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2018 se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur nuk figurojnë pasuri të regjistruara. Momentalisht, nga ASHK-të Tiranë dhe Fier ende nuk kanë ardhur përgjigjet e kërkesës së dërguar nga Komisioni, për shkak të mosmarrëveshjeve ndërinstitucionale lidhur me tarifat e aplikueshme. ASHK-ja Përmet ka informuar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.9.2020 se shtetasit A. Th. D. dhe V. D. (vjehtërit e subjektit të rivlerësimit) kanë në bashkëpronësi pasurinë e paluajtshme të llojit apartament me sipërfaqe 67.54 m<sup>2</sup>, nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, Përmet, përfituar me anë të privatizimit. Kontrata për privatizimin e banesës, datë 25.2.1998, nënshkruar midis shtetasit A. D. dhe Entit të Banësive, kundrejt çmimit total 17.049 lekë.

<sup>11</sup> Dorëzuar në datën 26.1.2017.

<sup>12</sup> Dorëzuar në datën 10.3.2017.

17. Ky automjet është blerë nga shtetasi M. Sh., i cili më parë e kishte blerë këtë automjet në vitin 2012, kundrejt çmimit 900 euro<sup>13</sup> dhe kishte kryer edhe pagesat për detyrimet doganore, në vlerën 31.386 lekë<sup>14</sup>. Subjekti është shprehur në përgjigje të pyetësorit nr. 2, se me palën shitëse të këtij automjeti nuk ka pasur ndonjë lidhje familjare/shoqërore apo të çfarëdolloji<sup>15</sup>.
18. Përgjatë hetimit administrativ për këtë pasuri, Komisioni ka administruar: (i) nga DPSHTRr-ja me shkresat nr. \*\*\* prot., datë 16.8.2017, nr. 13160/4 prot., datë 29.8.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2020, është konfirmuar se në emër të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit figuron i regjistruar automjeti me targa \*\*\*, duke bashkëngjitur dosjen e regjistrimit të automjetit; (ii) kontrata e shitblerjes së automjetit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 7.6.2016, e lidhur ndërmjet palës shitëse M. Sh. dhe palës blerëse Arta dhe E. D., për blerjen e automjetit tip “Audi A4”, vit prodhimi 2002, me nr. shasie \*\*\*, kundrejt çmimit 330.000 lekë, shumë kjo e likuiduar njëherazi jashtë zyrës noteriale.

### **Lidhur me analizimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie**

19. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* të disponuar në banesë në vlerën 200.000 lekë (të krijuar me kursimet nga paga e saj dhe e bashkëshortit) dhe në DIPP-në e vitit 2016, në rubrikën e ndryshimit të pasurive, ka deklaruar pakësimin/shpenzimin e kësaj gjendjeje *cash* për blerjen e automjetit në fjalë.
20. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se në vitin 2015, subjekti së bashku me bashkëshortin, kanë realizuar të ardhura totale në vlerën 1.398.588 lekë<sup>16</sup> dhe kanë pasur shpenzime në vlerën 1.053.831 lekë<sup>17</sup>. Nga përlllogaritja e të dhënave të mësipërme ka rezultuar se familja e subjektit mund të kursente në vitin 2015, në gjendje *cash* në vlerën 200.000 lekë, me burime të ligjshme financiare.
21. Nisur nga deklarimi i subjektit se burimi i krijimit të kësaj pasurie është nga kursimet e disponuara *cash* të krijuara nga pagat e saj dhe të bashkëshortit, Komisioni verifikoi lëvizjet në llogaritë bankare, lidhur me mundësinë e tërheqjes së diferencës në vlerën 130.000 lekë, për të plotësuar çmimin e blerjes së automjetit prej 330.000 lekësh – veç gjendjes *cash* prej 200.000 lekësh. Nga të dhënat e konstatuara përgjatë periudhës janar – 7.6.2016, rezultoi se janë kryer tërheqje *cash* në shumën totale prej 510.000 lekësh dhe është derdhur në llogari shuma prej 51.000 lekësh. Duke konsideruar dhe zbritur edhe shpenzimet e jetesës për këtë periudhë në vlerën prej 235.092 lekësh<sup>18</sup> dhe të qirasë vetëm për një muaj (të cilat janë kryer

<sup>13</sup>Referuar një deklaratë zëvendësuese të aktit noterial, të përkthyer në gjuhën shqipe.

<sup>14</sup> Nga një përlllogaritje rezulton se investimi total i palës shitëse për këtë automjet ka qenë në vlerën rreth 157.133 lekë.

<sup>15</sup> Lidhur me konfliktin e interesit për këtë shtetas, subjekti ka vendosur në dispozicion të Komisionit vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2020, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, në të cilin konfirmohet se subjekti nuk ka shqyrtuar çështje gjyqësore me shtetasin M. Sh..

<sup>16</sup> Subjekti ka realizuar të ardhura nga paga si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier në vlerën 1.057.314 lekë, referuar vërtetimit të kësaj të fundit, datë 18.1.2017. Ndërsa bashkëshorti ka realizuar të ardhura gjatë vitit 2015 në vlerën prej 341.274 lekësh, referuar vërtetimit të ISSh-së Drejtoria Rajonale Fier me nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016, sipas të cilit ka përfituar të ardhura nga Bashkia Fier për periudhën janar 2015 – maj 2015, në vlerën 209.455 lekë dhe nga IEVP Fier për periudhën tetor 2015 – dhjetor 2015, në vlerën 98.482 lekë (kjo e fundit vërtetuar edhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2016). Gjatë periudhës qershor – tetor 2015, bashkëshorti ka përfituar asistencë (pagesë papunësie) në vlerën 33.387 lekë.

<sup>17</sup> Përfshirë dhe shpenzimet mjekësore në vlerën prej 378.513 lekësh, të deklaruara nga subjekti në DIPP të vitit 2015 dhe të konfirmuara me faturën nga Spitali Amerikan në datën 20.4.2015. Subjekti ka vënë në dispozicion edhe mandatin e tërheqjes nga llogaria e kursimit në “Alpha Bank”, në vlerën prej 500.000 lekësh, datë 15.4.2015, me të cilat janë mbuluar këto shpenzime.

<sup>18</sup> Përlllogaritur shpenzime jetese për dy persona, pasi subjekti ka lindur fëmijën në datën 12.7.2016, pra, pas blerjes së automjetit në analizë. Për të gjithë vitin 2016, shpenzimet e jetesës në analizën financiare janë konsideruar sipas standardit të përdorur nga ILDKPKI-ja (të dhëna zyrtare të INSTAT-it), për gjysmën e vitit me dy persona dhe për gjysmën tjetër me tre persona.



në datën 3.3.2016 me derdhje *cash*), pasi pagesat e muajve të tjerë gjatë kësaj periudhe janë kryer me urdhërxhirim nga llogaria e bashkëshortit në “Credins Bank” në llogarinë e qiradhënësit – ka rezultuar mundësia financiare me burime të ligjshme, siç është paraqitur më poshtë, në mënyrë të përmbledhur analiza e burimeve të përdorura për blerjen e automjetit në analizë.

Tabela nr.1: burimet e përdorura për blerjen e automjetit

Terheqje nga llogarite bankare 01.01-07.06.2016	510 000
Derdhur ne llogari	(51 000)
Blere automjeti	(330 000)
Kursime te disponuara cash ne fund te 2015	200 000
Shpenzime jetese janar - qershor 2016	(235 092)
Shpenzime qiraje shkurt 2016	(18 000)
<b>Rezultati</b>	<b>75 908</b>

22. Nga sa më sipër, në konkluzion të hetimit administrativ të Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri financiare për blerjen e këtij automjeti, në vitin 2016, me burime të ligjshme.

**4. Gjendje në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit në bankat e nivelit të dytë, si vijojnë:**

- a. gjendje në llogarinë e kursimit në “Alpha Bank”, në vlerën 247.931,49 lekë;
- b. gjendje në llogarinë e pagës së subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank”, në vlerën 15.898,93 lekë;
- c. gjendje në llogari kursimi të subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank”, në vlerën 23.083,95 lekë;
- d. gjendje në llogari karte me parapagim të subjektit në “Intesa Sanpaolo Bank”, në vlerën 1.000 lekë;
- e. gjendje në llogarinë e pagës së bashkëshortit të subjektit në “Credins Bank”, në vlerën 13.975 lekë;
- f. gjendje në llogari kursimi të bashkëshortit të subjektit në “Credins Bank”, në vlerën 60.072 lekë.

23. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar rregullisht – duke filluar nga deklarimi përpara fillimit të detyrës e deri në deklaratën *Vetting* – shtesat apo pakësimet në llogaritë bankare të pagave dhe/apo të kursimeve *cash*, të saj dhe të bashkëshortit.

24. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar burimin e krijimit për këto llogari nga të ardhurat nga paga e saj dhe e bashkëshortit.

25. Nga verifikimi i lëvizjeve të llogarive bankare në analizë, konstatohet se gjendjet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, ndër vite, dhe në deklaratën *Vetting*, përputhen me gjendjet e rezultuara nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, si dhe burimi i krijimit të tyre ka rezultuar i ligjshëm dhe i krijuar nga pagat nga puna respektive.

**5. Gjendje *cash* në vlerën 250.000 lekë**

26. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting*, gjendje të disponuar *cash* në banesë në shumën 250.000 lekë, të krijuar përgjatë vitit 2016, me burim krijimi nga të ardhurat nga pagat e saj dhe të bashkëshortit.
27. Me qëllim verifikimin e burimit të kursimeve të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, Komisioni analizoi llogaritë bankare ku ishin derdhur pagat e subjektit dhe të bashkëshortit, nga të cilat është konstatuar se përgjatë vitit 2016 është tërhequr në total shuma 1.226.000 lekë dhe është derdhur 51.000 lekë. Gjithashtu, Komisioni përlllogaritë si shpenzime jetese për vitin 2016, shumën prej 587.730 lekësh<sup>19</sup>, ku janë konsideruar dhe përfshirë edhe shpenzimet e qirasë, vetëm për 7 muaj, të cilat janë kryer me derdhje *cash*, (pasi pagesat e muajve të tjerë gjatë kësaj periudhe janë kryer me urdhërxhirim nga llogaria e bashkëshortit të subjektit në “Credins Bank” në llogarinë e qiradhënësit). Nga përlllogaritja e të gjitha të dhënave të larpërmendura, ka rezultuar sa është pasqyruar në tabelën e mëposhtme, në mënyrë të përmbledhur, nga ku rezulton mundësia e kursimit me burime të ligjshme, të shumës prej 250.000 lekësh, në fund të vitit 2016.

Tabela nr. 2: mundësia e kursimit të subjektit në vitin 2016

Terheqje nga llogarite bankare 01.01-31.12.2016	1 226 000
Derdhur ne llogari	(51 000)
Blere automjeti	(330 000)
Kursime te disponuara cash ne 2015	200 000
Shpenzime jetese 2016	(587 730)
Shpenzime qiraje 2016	(126 000)
Gjendje cash ne fund te vitit 2016	(250 000)
<b>Rezultati</b>	<b>81 270</b>

28. Në konkluzion të hetimit administrativ të Komisionit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri financiare për kursimin dhe krijimin e gjendjes *cash* në vlerën prej 250.000 lekësh, me burime të ligjshme financiare gjatë vitit 2016.

## 6. Gjetje të tjera

29. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011, blerjen e automjetit tip “Seat Ibiza”, viti i prodhimit 1998, me vlerë 200.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga kursimet familjare dhe nga pagat. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar dhurimin e këtij automjeti në favor të shtetasit P. B. (vëllait të saj) me kontratën e dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.7.2016.
30. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me tjetërsimet e këtij automjeti, ka vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës, nga ku (veç kontratës së dhurimit në vitin 2016), konstatohet se automjeti në fjalë është blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.12.2011, nga shtetasi N. S., kundrejt çmimit 200.000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr.

<sup>19</sup> Përlllogaritur shpenzime jetese për dy persona për gjashtë muajt e parë të vitit, pasi subjekti ka lindur fëmijën në datën 12.7.2016 dhe për gjysmën tjetër për tre persona, sipas standardit të përdorur nga ILDKPKI-ja (nga të dhënat zyrtare të INSTAT-it).

2, subjekti ka informuar se pagesa për blerjen e automjetit në fjalë, në vitin 2011, është kryer *cash*.

31. Nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar ndonjë shumë të disponuar *cash* në banesë, në fund të vitit 2010, Komisioni, për të verifikuar burimet financiare, ka analizuar tërheqjet e kryera nga llogaritë bankare respektive, përgjatë vitit 2011 deri në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes më 21.12.2011, nga ku ka rezultuar gjendje në vlerën 665.000 lekë dhe pasi nga të cilat janë zbritur edhe shpenzimet e jetesës në vlerën 273.240 lekë<sup>20</sup>, ka mbetur një shumë e mjaftueshme për kryerjen e investimit në fjalë (blerjen e automjetit me burime të ligjshme). Më poshtë, në mënyrë të pëmbledhur, janë paraqitur përlllogaritjet e burimeve të përdorura për blerjen e automjetit tip “Seat Ibiza”, në vitin 2011.

Tabela nr. 3: burimet e përdorura për blerjen e automjetit në vitin 2011

Terheqje nga llogarite bankare 01.01-21.12.2011	665 000
Blere automjeti	(200 000)
Kursime te disponuara cash ne fund te 2010	-
Shpenzime jetese 2011	(273 240)
<b>Rezultati</b>	<b>191 760</b>

32. Lidhur me këtë automjet, nga hetimi administrativ i Komisionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mjaftueshmëri financiare për blerjen e automjetit tip “Seat Ibiza”, në vitin 2011 me burime të ligjshme financiare dhe ka deklaruar saktë në DIPP-të përkatëse, blerjen e këtij automjeti në vitin 2011, si dhe dhurimin e tij në vitin 2016.

### ANALIZA FINANCIARE

33. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi pasuritë e deklaruara në deklaratën *Vetting*, si dhe në deklaratimet periodike ndër vite, duke përfshirë të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre, është vlerësuar dhe konkluduar mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
34. Në konkluzion, pasi janë analizuar dhe vlerësuar nga trupi gjykues edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, nga analiza financiare e kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Komisionit, pasi janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2010, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, deri në vitin 2016, si rezultat i përgjithshëm vjetor dhe përfundimtar ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm pozitiv, pa mungesa të burimeve financiare.

<sup>20</sup> Referuar shpenzimeve jetike për një familje me dy pjesëtarë, sipas standardit të përdorur nga ILDKPKI-ja (nga të dhënat zyrtare të INSTAT-it).

**Tabela e analizës financiare për periudhën 2010 - 2016**

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>54 269</b>	<b>264 283</b>	<b>24 929</b>	<b>122 110</b>	<b>175 635</b>	<b>-103 489</b>	<b>576 853</b>
Toke bujqesore 24 DY ne Bulgarec, Korce (7501)							
Autoveture Seat Ibiza, viti 1998		200 000					
Autoveture Audi A4, viti 2002							330 000
Ndryshim likuiditeti	54 269	64 283	24 929	122 110	175 635	-103 489	246 853
<b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b>	<b>137 183</b>	<b>201 466</b>	<b>226 395</b>	<b>348 504</b>	<b>524 139</b>	<b>420 650</b>	<b>667 503</b>
<b>DETYRIME</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>PASURI NETO</b>	<b>54 269</b>	<b>264 283</b>	<b>24 929</b>	<b>122 110</b>	<b>175 635</b>	<b>-103 489</b>	<b>576 853</b>
<b>Të ARDHURA dokumentuar</b>	<b>588 554</b>	<b>833 078</b>	<b>1 032 318</b>	<b>1 294 997</b>	<b>1 381 233</b>	<b>1 398 588</b>	<b>1 418 407</b>
Paga SR vertetuar	588 554	833 078	828 120	862 506	1 076 610	1 057 314	871 491
Paga BSH vertetuar	-	-	204 198	432 491	304 623	341 274	546 916
<b>SHPENZIME</b>	<b>273 240</b>	<b>273 240</b>	<b>471 608</b>	<b>578 362</b>	<b>711 926</b>	<b>1 174 844</b>	<b>803 730</b>
Shpenzime jetese	273 240	273 240	282 048	282 048	439 996	448 552	587 730
Shpenzime mjekesore						378 513	
Shpenzime qiraje			160 000	192 000	192 000	206 000	216 000
Shpenzime udhetimi			17 560	99 314	63 890	126 519	
Shpenzime per siguracion automjeti			12 000	5 000	16 040	15 260	
Analiza dokumentuar	261 045	295 555	535 782	594 525	493 672	327 232	37 824
CASH në lekë						200 000	250 000
<b>DIFERENCA E PAMBULUAR</b>	<b>0</b>						

### B. KONTROLLI I FIGURËS

35. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë në Komision një raport me nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Duka.
36. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2020, DSIK-ja i ka komunikuar Komisionit se raporti i sipërcituar është deklasifikuar plotësisht në datën 3.12.2020, me vendimin nr. \*\*\*, KDZH-së.
37. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese, përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni, nuk kanë rezultuar informacione apo fakte të reja lidhur me këtë kriter. Për rrjedhojë – në vijim të hetimit administrativ dhe rivlerësimit të kryer, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016, si dhe bazuar në dokumentet e administruara – në vlerësim të kriterit të kontrollit të figurës, në tërësi, Komisioni arrin në përfundimin se për sa kohë nuk janë gjetur fakte apo rrethana që mund të çonin në një konkluzion të ndryshëm nga ai i arritur nga DSIK-ja, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar i përshtatshëm për vijimin e detyrës.

### C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

38. Komisioni, në bazë të neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka studiuar dhe analizuar raportin e KLGj-së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur – ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës. Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në:

- a. raportin me nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2020, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga KLGj-ja;
- b. informacionin e marrë nga burime të ligjshme, si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga denoncime të publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016;
- c. kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**C/1 Lidhur me analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGj-ja**

- 39. Raporti i përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka konstatuar sa vijon.
- 40. Lidhur me subjektin e rivlerësimit, znj. Arta Duka, për periudhën e rivlerësimit, pasi janë analizuar materialet e depozituara nga subjekti dhe ato të përzgjedhura në mënyrë rastësore, KLGj-ja është shprehur si në vijim.
- 41. Nga pikëpamja formale, vendimet paraqiten me strukturë të qëndrueshme. Janë respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdoren të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Fjalitë paraqiten me gjatësi normale dhe të kuptueshme. Në të pesta vendimet e shqyrtuara mund të thuhet se vendimet e mësipërme plotësojnë standardet e vendimit gjyqësor të arsyetuar.
- 42. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale, konstatohet se gjyqtarja Arta Duka ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 8.7.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2011. Fillimisht është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të kryer stazhin profesional, bazuar në dekretin nr. 6689, datë 27.9.2010, të Presidentit të Republikës dhe më pas me dekretin nr. 7202, datë 21.12.2011, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Znj. Arta Duka, me vendimin nr. 318, datë 16.9.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, komandohet në skemën e delegimit të ngritur pranë KLGj-së për të gjykuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë për periudhën deri më 16.9.2021.
- 43. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezultojnë se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Arta Duka është paraqitur 1 ankesë në vitin 2014 në Inspektoratin e KLD-së. Ankesa e vitit 2014 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje nga ana e gjyqtares. Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Arta Duka, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezultojnë të ketë ardhur ndonjë kërkesë nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë propozuar në ish-Këshillin e Lartë të Drejtësisë ndonjë masë për procedim disiplinor.
- 44. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2020, ka informuar se është regjistruar me nr. \*\*\* të vitit 2016 ankesa e shtetasit S.\* I.\*, i cili ka bërë edhe kallëzim penal ndaj gjyqtares për veprën penale “shpërdorim detyre”. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 10.9.2020, ka informuar se në datën 21.9.2016 është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\*, kundër subjektit të rivlerësimit për veprën penale “shpërdorim detyre” dhe, për këtë kallëzim, në datën 24.10.2016, është marrë

vendimi nr. \*\*\*, “*për mosfillimin e procedimit penal*”, vendim i cili nuk është ankimuar. Gjithashtu, në datën 5.7.2012 është regjistruar procedimi penal me nr. \*\*\*, referuar kallëzimit të subjektit të rivlerësimit për veprën penale “*fyerje e gjyqtarit*”, për të cilin në datën 26.9.2012 është vendosur pushimi i hetimeve, vendimi nuk është ankimuar.

45. Nga analiza e gjetjeve, që i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (ii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; si dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në KLGj, ka rezultuar sa më poshtë.

#### **Aftësitë profesionale**

##### *a) Njohuritë ligjore*

46. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arta Duka, ka shfaqur aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se subjekti identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret.

##### *b) Arsyetimi ligjor*

47. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arta Duka, ka aftësi shumë të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar, provat e marra në shqyrtim jo vetëm citohen, por edhe tregohet se çfarë u provua me përmbajtjen e tyre. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Vendimet e ndërmjetme shoqërohen gjithnjë me referencë ligjore.

#### **Aftësitë organizative**

##### *a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

48. Subjekti rivlerësimit, znj. Arta Duka, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Rendimenti i përfundimit të çështjeve bazuar në këto të dhëna është 92.7 %. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit është eficient dhe efektive në çështjet që ka shqyrtuar. Në shumicën e rasteve, gjykimet, duke përfshirë edhe tri dokumentet e zgjedhura, kanë përfunduar brenda afateve të arsyeshme. Gjithashtu, gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi edhe kohës së arsyetimit të vendimeve gjyqësore, ku në të gjitha rastet afatet ligjore janë respektuar.

##### *b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

49. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arta Duka, ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore në pesë dosjet e vëzhguara. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej saj, përmes vendimeve formale për caktimin e seancës përgatitore/pajtimimit apo gjyqësore.

##### *c) Aftësia për të administruar dosjet*

50. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, gjyqtarja Arta Duka ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpapia apo kërkesa penale për gjykim, fashikulli i gjykimit, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, vendimet për kalimin e çështjes për shqyrtim apo vendimet përfundimtare, fletëthirrjet, provat dhe vendimi përfundimtar etj.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *a) Etika në punë*

51. Nga analiza e të dhënave në dosjen personale konstatohet se gjyqtare Arta Duka ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 8.7.2008 dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2011. Subjekti Arta Duka ka filluar detyrën me dekretin nr. 6689, datë 27.9.2010, të Presidentit të Republikës, ku është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të kryer stazhin profesional. Më tej, nga data 21.12.2011, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Znj. Arta Duka, me vendimin nr. 318, datë 16.9.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, komandohet në skemën e delegimit të ngritur pranë KLGj-së.

#### *b) Integriteti*

52. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Arta Duka, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Për këtë gjyqtare, gjatë periudhës së rivlerësimit (8.10.2013 – 8.10.2016), është paraqitur vetëm një ankesë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, e cila pas verifikimit rezultoi e pabazuar.

#### *c) Paanësia*

53. Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Duka. Për gjyqtaren Arta Duka, nuk u konstatua asnjë kërkesë për përjashtimin e saj nga gjykimi në pesë dosjet e vëzhguara. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### *a) Aftësitë e komunikimit*

54. Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarje Arta Duka, komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ajo ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore dhe gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

*b) Aftësia për të bashkëpunuar*

55. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e gjyqtarës Arta Duka, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Nuk janë evidentuar raste të shpeshta, që të ketë pasur vonesa në fillimin e seancave gjyqësore apo vonesa në arsyetimin e vendimeve, gjë që tregon se bashkëpunimi i saj me administratën gjyqësore dhe kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

*c) Gatishmëria për t'u angazhuar*

56. Subjekti i rivlerësimit, znj. Arta Duka, i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

**C/1 Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni**

57. Komisioni, në bazë të neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLGj –së, si dhe dokumentacionin e bashkëngjitur, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke shqyrtuar edhe informacionet e marra nga denoncimet nga publiku dhe duke analizuar aktet/vendimet/dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.

**DENONCIME NGA PUBLIKU**

58. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur nga publiku katër denoncime, të cilët janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse dhe janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore, për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Duka. Komisioni, pasi ka shqyrtuar denoncimet që janë paraqitur nga publiku pranë këtij institucioni, ka konstatuar sa vijon.

**1. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2018, nga shtetasi L\*. B\*.**

59. Shtetasi L\*. B\*. denoncon një grup prej 22 subjektësh rivlerësimi, ndër të tjerë edhe subjektin e rivlerësimit, për zhvillim procesi jo të rregullt ligjor. Nga verifikimi i dokumentacionit të disponuar rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë pjesë e trupës gjyqësore në çështjen me palë shtetasin L\*. B\*. Për sa më sipër, Komisioni ka vlerësuar se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, denoncimi nuk përmbante fakte apo rrethana konkrete që mund të përbënin objekt vlerësimi në lidhje me aspektin profesional për subjektin e rivlerësimit.

**2. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 26.8.2019, i shtetasit F\*. F\*.**

60. Shtetasi F\*. F\*. ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për vendimmarrje të padrejtë dhe mosmarrjen në konsideratë të kërkesave të avokatit. Nga dokumentacioni në dispozicion është konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. \*\*\*, datë 20.2.2017, me objekt: “*Ndryshimin e vendimit civil nr. \*\*\*, datë 8.7.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, lidhur me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për fëmijët M. F. dhe A. F., lënien e fëmijëve për rritje dhe edukim paditëses me familjen e saj në Belgjikë*”.



61. Nga shqyrtimi i të dhënave në fjalë ka rezultuar se vendimi i lartpërmendur është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.4.20219. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana konkrete që mund të evidentojnë shkelje procedurale apo arsyetim të dobët nga subjekti, apo ndonjë tjetër rrethanë që mund të kishte lidhje me kriterin profesional të subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Duka.

### **3. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2019, i shtetasit E\*. C\*.**

62. Shtetasi E\*. C\*. ka denoncuar subjektin e rivlerësimit për shkelje ligjore në vendimmarrjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 17.7.2019, me objekt: *“lëshimin e urdhrin të ekzekutimit”*. Shtetasi pretendon se nga gjyqtarja Arta Duka janë shkelur rregullat e caktimit të urdhrin të mbrojtjes, pasi: (i) personi që dyshohet se e ka kërcënuar me mesazhe nuk jeton në Shqipëri; (ii) koha e gjatë e dhënies prej një viti e këtij urdhri e bën atë të paekzekutueshëm dhe një akt absolutisht të pavlefshëm; (iii) largimi i paditëses tri ditë pas marrjes së këtij vendimi e bën përsëri të pavlefshëm urdhrin e ekzekutimit.

63. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka dhënë vendimin nr. \*\*\*, datë 17.7.2019, pasi kishte thirrur rregullisht të paditurin, por ky i fundit nuk ishte paraqitur në gjykim dhe, rrjedhimisht, shqyrtimi i çështjes ka vijuar në mungesë. Gjithashtu, rezultoi se në gjykim është paraqitur si provë edhe një deklaratë e palës paditëse e lëshuar para punonjësit të Policisë së Shtetit, është kryer këqyrja e telefonit të paditëses, në seancë gjyqësore, nga ku gjykata ka konstatuar se gjendeshin biseda të kryera nëpërmjet aplikacionit WhatsApp me të paditurin. Në përfundim të analizimit të provave dhe kuadrit ligjor, subjekti i rivlerësimit ka vendosur *“lëshimin e urdhrin të mbrojtjes për paditësen A. N., duke urdhëruar edhe marrjen e masave përkatëse”*.

64. Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim i referohet zgjidhjes në themel të çështjes dhe nuk përmban fakte apo rrethana konkrete mbi shkelje procedurale, që mund të përbëjnë objekt vlerësimi në lidhje me kriterin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Duka.

### **4. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2019, i shtetasit Th\*. Ç\*.**

65. Në Komision, me shkresën nr. \*\*\*prot., datë 30.9.2019, nga Kolegji i Posaçëm i Apelit është përcjellë denoncimi nga publiku që i përket shtetasit Th\*. Ç\*. i cili denonconte gjashtë subjekte rivlerësimi, midis tyre edhe znj. Arta Duka. Nga dokumentacioni bashkëlidhur këtij denoncimi nuk është konstatuar që subjekti i rivlerësimit të ketë shqyrtuar çështjen gjyqësore të përmendur dhe, për rrjedhojë, nuk rezultojnë fakte apo rrethana konkrete që mund të evidentojnë ndonjë shkelje procedurale, arsyetim të dobët apo përfshirje të subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Duka.

66. Në këto kushte, trupi gjykues, pasi ka çmuar faktet dhe rrethanat që lidhen me aktet e shqyrtuara më herët nga KLGJ si dhe me denoncimet nga publiku, nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit profesional, mbërrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj.

Arta Duka, ka arritur një nivel mëse kualifikues lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

### **KONKLuzion PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Arta Duka:

1. ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
2. ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
3. ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjekti i rivlerësimit, znj. Arta Duka, duhet të konfirmohet në detyrë.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe neni 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Arta Duka, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier<sup>21</sup>.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në datën 6.1.2021.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Brunilda BEKTESHI**  
**Kryesuese**

---

<sup>21</sup> Në datën 16.9.2020, znj. Arta Duka është komanduar në skemën e delegimit në Gjykatën e Apelit Korçë.

**Lulzim HAMITAJ**  
**Relator**

**Olsi KOMICI**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Anisa Duka*